

VENDIM
Nr. 185, datë 4.4.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 933, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
STRUKTURËS ORGANIZATIVE TË
QENDRËS KOMBËTARE TË
URGJENCËS MJEKËSORE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 147/2014, “Për Shërbimin e Urgjencës Mjekësore”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 933, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore (QKUM) është person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për shëndetësinë. Organika e QKUM-së të jetë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Numri i punonjësve të QKUM-së të jetë, gjithsej, 86 veta.”.

b) Lidhja 1, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

	ORGANIKA E QENDRËS KOMBËTARE TË URGJENCËS MJEKËSORE	Nr.
1	DREJTOR I PËRGJITHSHËM	1
	Sekretar	1
2	Drejtoria e Financës, Investimeve dhe Buxhetit	[23]
	Drejtori	1
2	Spektori i Financës dhe i buxhetit	6
	Përgjegjës sektori	1
	Specialistë (financë/buxhet)	3
	Llogaritar	1
	Specialist investimesh (ekonomist, inxhinier)	1
2	Spektori i Shërbimeve Mbështetëse	[16]
	Përgjegjës sektori	1
	Specialist (burime njerëzore)	1
	Specialistë (jurist)	2
	Arkivist	1
	Shoferë	3
	Sanitare	4
	Magaziniere	1
	Specialist (prokurimi)	1
	Teknik i mesëm (specialitete të ndryshme)	2
3	Drejtoria e Koordinimit të Urgjencave Mjekësore	[53]
	Drejtor	1
3	Spektori i Njësisë së Koordinimit të Urgjencave	[43]
	Përgjegjës sektori (mjek)	1
	Kryeinfermier urgjence	1
	Mjekë (urgjence)	16
	Infermierë (urgjence)	25
3	Spektori i Trajnimeve, i Certifikimeve dhe i Akreditimit	[4]
	Përgjegjës sektori (shkenca mjekësore)	1
	Specialistë (shkenca mjekësore)	3
3	Spektori i Parandalimit, Kontrollit të Cilësisë dhe Edukimit	[5]
	Përgjegjës sektori (shkenca mjekësore)	1
	Specialistë (shkenca mjekësore)	4
4	Drejtoria e Komunikimit, Statistikës dhe Regjistrimit të Urgjencës	[8]
	Drejtor	1
4	Spektori komunikimit	[3]
	Përgjegjës sektori	1
	Specialistë	2
	Spektori i Statistikës dhe Regjistrimit të Urgjencës	[4]
4	Përgjegjës sektori	1
	Specialistë	2
	Operator	1
	Numri total	86